

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike””

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Ky projektligj është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 59, datë **09.05.2022**, me përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit (DPPSH) dhe Akademisë së Sigurisë.

Ky projektligj është konsultuar në mbledhjet e grupit të punës, përkatësisht në datat 19.05.2022, 31.05.2022, 10.06.2022, 17.06.2022 dhe 01.07.2022.

Gjithashtu, në datën 12.07.2022 u zhvillua tryeza në Ministrinë e Brendshme me rreth 15 përfaqësues të shoqatave dhe shoqërive private të sigurisë fizike, pasi krahas listës së shoqatave dhe Shpsf-ve me 12 përfaqësues të njoftuar nga DPPSH dhe të konfirmuar, kishte edhe përfaqësues të shoqërive të tjera të cilat u paraqitën.

Konsultimi publik në RENJK për periudhën kohore në respektim të ligjit, nga data 17 tetor 2022 deri më datë 14 nëntor 2022. Si përfundim, kohëzgjatja e konsultimit në tërësi ka qenë nga data 09.05.2022 deri më 14 nëntor 2022.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për **Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike””** ishin tre:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK për periudhë të paktën 20 ditë pune sipas ligjit, përafërsisht një muaj duke filluar nga data 17 tetor 2022 deri më 14 nëntor 2022.

2. Tryeza publike me shoqata dhe Shpsf-të, krahas takimeve të grupit të punës mbajtur më datë 12 korrik 2022.
3. Email.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Grupi i punës i ngritur me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 59 datë 09.05.2022;
 - Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në MB;
 - Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;
 - Përfaqësues të Policisë së Shtetit, DPPSH;
 - Përfaqësues të Akademisë së Sigurisë;
 - 15 përfaqësues të shoqatave dhe Shoqërive private të sigurisë fizike me aktivitet në disa qarqe të vendit, konkretisht më poshtë po paraqesim 12 prej tyre, si vijojnë:
1. Shoqata “Union Security Albania” Kryetari Gëzim Demiraj
 2. Shoqata “Bashkimi Kombëtar i Shoqërive të Ruajtjes” (BKSHR) Kryetari Astrit Miho
 3. Shpsf “Arb Security” titullar Perparim Hasani drejtues teknik Flamur Sala,
 4. Shpsf “Aulona Pol-1” titullar Vasil Mërtiri, Ortak (Flamur Çela), drejtues teknik Ilir Gjoçi
 5. Shpsf “Nazeri 2000” titullar Alfred Zylali, Ortaku Durim Nazeri, drejtues teknik Mehmet Baze
 6. Shpsf “Rogat Security” titullar Begator Mane, drejtues teknik Dod Dodaj
 7. Shpsf “Breçani Security” titullar Fatbardh Breçani, drejtues teknik Bashkim Boletini
 8. Shpsf “Pelikani Security” titullar Vesel Demiraj, drejtues teknik Flamur Muka
 9. Shpsf “Global Security” titullar Fatos Malaj, drejtues teknik Ibrahim Beraj
 10. “Illyrian Guard” titullar Robert Lili, drejtues teknik Qamil Abedin
 11. Shpsf “Myrto Security” titullar Hysni Myrtaj, drejtues teknik Skënder Mehmeti.
 12. Shpsf “Anakonda Security” titullar Alfred Shehu.
- Koordinator i për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara (renditni të gjithë)	Vendimi (I pranuar/I pranuar	Justifikimi
--------------------	---------	--	------------------------------	-------------

<i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	<i>(grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	<i>ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	<i>pjesërisht/I refuzuar)</i>	